

Pastrimi i mjedisit nga tymi i duhanit

Martin Mc Kee, Fatime Arënlju Qosaj

Kosova më në fund është në pozitë që mund të përparojë duke zhvilluar politika të cilat do të promovojnë dhe mbrojnë shëndetin e saj. Një prej sfidave kryesore të saj është si të zvogëloj sëmundjet që kanë lidhëshmëri me pirjen e duhanit, në mesin e duhan pirësve si dhe atyre që i ekspozohen tymit të duhanit nga të tjerët. Një numër gjithnjë e më i madh i shteteve po i bashkangjitet pionerëve si Irlanda, Norvegjia dhe New York, për të ndaluar pirjen e duhanit. Por nëse autoritetet Kosovare do të prezantonin një politikë të ngjashme ata do të ballafaqoheshin me një kundërvënie nga grupet e lobit të fuqishëm përmes kompanive të duhanit ose organizatave përfaqësuese të tyre të cilët do të kërkonin t'i bllokoni ato. Përvoja e përpjekjeve të Irlandës që të prezantoi ndalesën na jep idenë për numrin e dezinformatave të cilat mund të priten . Tani del qartë se me dekada ishim të përgënjeshtuar nga industria e duhanit. Si punonjës të shëndetësisë publike, një Irlandez dhe një Kosovar, mendojmë se është esenciale që edhe politikanët që marrin këtë vendim ta dijnë të vërtetën.

Një nga shembujt më famëkeq të hipokrizisë së industrisë është ajo e 1994 kur shefat e ekzekutivit të shtatë kompanive më të mëdha të duhanit dëshmuuan në Kongresin Amerikan se nikotina nuk shkakton varshmëri edhe pse dokumentet e tyre të brendshme qartë e pranonin të kundërtën. Në të vërtetë, me vite ata manipulonin me përmbajtjen e cigareve për ta rritur nivelin e nikotinit ashtu që ta përshpejtojnë paraqitjen e varshmërisë në mesin e duhanxhinjëve të rinj. Të kuptuarit e shkallës së mashtimit ishte si pasojë e ndjekjeve ligjore në SHBA, të cilat e detyruan industrinë e duhanit që të lejojë shikimin e miliona faqeve të dokumenteve të brendshme. Kjo i bëri të njohur hollësitë që ishin përgatitur për të shtrembëruar evidencën shkencore. Që nga viti 1977, ekzekutivët e industrisë nga kompanitë e ndryshme takoheshin, shpesh në mënyrë sekrete, që të diskutonin mënyrat si të mbajnë gjallë iluzionin se kishte polemikë të vërtetë shkencore nëse duhani ishte i dëmshëm. Ata përdorën teknika të ndryshme. Reklama, përmes një kampanje që synonte të bindte se çdo gjë në jetë është rrezikshme sikur dhe të ngrënit biskota, edhe pirja pasive e duhanit nuk ishte ndryshe. Përveq kësaj ata poashtu u zotuan në një program të madh për të përkrahur kërkime të cilat zakonisht ishin të gabuara dhe herë pas herë mashtruese. Shumë nga këto përpjekje ishin dedikuar për pengimin e përparimit të evidencës në rritje lidhur me dëmet e pirjes pasive të duhanit, kryesisht duke bindur se bashkëshortet jo duhanxhi të duhanxhive në disa mënyra ndryshonin nga pjesa tjetër e popullatës. Që përpjekjet e tyre ishin aq të mëdha nuk është për tu habitur duke pasur parasysh faktin sa shumë kishin për të humbur. Një shembull, kur Agjensioni Ndërkombëtar për Kërkime të Kancerit publikoi atë që shumë njerëz e konsideronin si definitive lidhur me efektet e dëmshme të shkaktuar nga duhanpirja pasive, ata shpenzuan 4 milion \$ për kampanjën kundër kësaj.

Sa e dëmshme është duhanpirja pasive? Industria e duhanit bind se është tepruar me rrezikun që kanos duhan pirja pasive. Në fakt, ne e kemi ditur se është e rrezikshme për dy dekada. Në vitin 1981 një hulumtues Japonez publikoi një studim që bashkëshortet jo duhanpirëse të duhanpirësve janë në rrezik dukshëm më të lartë të sëmuren nga kanceri i mushkërive në krahasim me bashkëshortet të cilat jetonin me jo duhanpirësit. Nga mesi i

1990-tave ky zbulim u vërtetua në mbi 30 studime tjera, ku disa nga ato tregojnë se efektet nuk ishin të kufizuara vetëm në kancerin e mushkërive dhe se duhanpirja pasive ishte shkaktar kryesor i sëmundjeve të zemrës. Të gjitha këto studime vlerësuan në mënyrë indirekte eksponimin ndaj duhanpirësve, në bazë të prezencës së duhanpirësve në të njëjtën ambient. Industria e duhanit e kritikoi këtë qasje, edhe pse kjo qasje kishte mundësi të nënvlerësonte çdo efekt. Por kërkimet më të reja e tejkalojnë këtë kufizim dhe vlerësojnë në mënyrë direkte eksponimin ndaj tymit nga duhanpirësit duke matur nivelin e produkteve të shpërbërjes së nikotinës në mostrat e gjakut. Kjo qasje e studimit tregoi se rreziku ishte shumë më i madh se që ishte dyshuar të jetë. Rreziku për sëmundje koronare (enëve të gjakut) të zemrës te personat që nuk pinë duhan por i ekspozohen nivelit të lartë të pirjes së duhanit nga të tjerët rritet për 60% dhe ky është vlerësimi pasi të janë marrë parasysh të gjithë faktorët tjerë të zakonshëm të rrezikut. Për më tepër, ne tani e dimë se studimet sekrete që janë bërë në shtazë nga industria e duhanit tregojnë se rrjedha anësore e tymit (tymi që lirohet gjatë djegjes së cigareve në taketuke) është edhe më e dëmshme se sa tymi i emituar nga duhanpirësit pasi ta kenë thithur duhanin (rrjedha kryesore). Ky lloj i tymit do të tretet në ajër më gjatë sepse partikulat e aerosolit në tym janë më të vogla se ato të rrjedhës kryesore. Kjo e dhënë e kombinuar me vetitë helmuese të tymit nga rrjedha anësore, e bën atë më të dëmshëm për tu thithur në krahasim me tymin e rrjedhës kryesore (tymi i emituar nga duhanpirësit pasi ta kenë thithur duhanin).

A funksionon ndalesa e duhanpirjes? Ne mund të presim shumë reaksione në mediat Kosovare duke thënë se ajo nuk do të funksionoj. Por secili që viziton Dublinin do të shohë se ndalesa funksionon. Për shembull, një reagim thoshte se njerëzit nga Republika e Irlandës do të shkonin me autobus në Irlandën Veriore për të pirë në një bar ku mund të pinin duhan. Problemi i vetëm ishte që orari i autobusëve në atë pjesë të Irlandës tregonte qartas se ata nuk do të mund të ktheheshin të njëjtën natë në shtëpitë e tyre!

A mund të zgjedhim problemin e duhanpirjes pasive me ventilim ashtu si propozon industria e duhanit? Shumicën e evidencës që ata citojnë është e tyre, nga studimet të cilat garantojnë të japin rezultate që ata dëshirojnë. Për dallim, studimet e pavarura tregojnë se për të reduktuar eksponimin në nivel të sigurtë kërkohen ventilatorë që fryejnë me shpejtësi të madhe (të tornados). Ne duhet të mbajmë në mend që vetëm nëse nuk ka erë të tymit të duhanit nuk do të thotë se nuk ka rrezik sepse shumë komponente të dëmshme janë pa erë. Në të vërtetë për këtë arsye industria e duhanit edhe ka punuar shumë për të zvogëluar erën mjedisore të duhanit.

Dhe më në fund shtrohet pyetja, a do të ul fitimet në kafene dhe restorane ndalimi i pirjes së duhanit? A do të shkaktoj papunësi? Ky është argumenti kryesor i industrisë së duhanit. Përsëri kjo është e pakuptimtë, nuk është befasi se shumica e njerëzve që nuk janë duhanpirës i shmangen kafeneve që janë shumë të tymosura nga duhani. Në New York, nëntë muaj pas ndaljes së pirjes së duhanit, të ardhurat nga taksat e shitjes u rritën për 12% dhe industria e hotelierisë dhe turizimit punësoi disa mijëra punëtorë. Arsyeja pse shumë njerëz kanë besuar se e kundërta do të ndodh del qartë nga studimet mbi efektet ekonomike të ndalesës së duhanpirjes të bërë nga shkencëtarët në Universitetin e Californisë në San Francisco. Shkencëtarët kanë gjetur 97 studime që kanë trajtuar këtë çështje. Cdo njëra nga 37 studimet që ka gjetur se të ardhurat nga shitjet kanë rënë kanë qenë të financuar nga industria e duhanit. Disa nga këto studime janë botuar në gazeta shkencore. Asnjëra nga 60 studimet e pavarura nuk gjeti ndonjë efekt të padëshirueshëm lidhur me efektet ekonomike. Duke pasur parasysh se shumica e njerëzve që vijnë nga

jasht në Kosovë janë joduhanpirës, ne mund të presim që Kosova të tërheq më shumë dhe jo më pak njerëz.

Kosova ka një popullsi shumë të re që është tërheqëse për tregun e industrisë së duhanit. Është vlerësuar se 50% të popullatës në Kosovë janë të moshës nën 25 vjeç dhe 31 % janë nën 15 vjeç. Këto përpjestime së bashku me të dhënat e Insitutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike (2005) ilustron më së miri se sa i rëndë është problemi i duhanpirjes në Kosovë. Sipas të dhënave më të reja të IKShP, 12.9% të nxënësve të shkollave fillore dhe 23,5% të shkollave të mesme janë duhanpirës aktual. Ndërsa 1/3 (37%) e nxënësve të shkollave fillore dhe ½ (53.9%) e nxënësve të shkollave të mesme ndonjëherë kanë pirë cigare. 29% të nxënësve të shkollave fillore kanë filluar të pijnë duhan para moshës 10 vjeçare krahasuar me 18.2% të nxënësve të shkollave të mesme. Pasojat e duhanit janë të vonshme dhe nëse nuk ndërmeren tani masat adekuate pritet që në të ardhmen e afërt sëmundjet që kanë lidhshmëri me duhanin të shkaktojnë rritje të shpenzimeve edhe ashtu të kufizuara në shëndetësi. Duhanpirja do të ngrit numrin e vdekjeve dhe atë më së shumti në mesin e atyre që janë eksponuar tymit nga duhanpirësit.

Duke pasur parasysh faktin që edhe ashtu shumica e duhanpirësve dëshirojnë të lënë duhanin ndalimi i duhanpirjes do ta përkrahte këtë kategori të duhanpirësve. Industria e duhanit do ta shfrytëzoj cdo rast që të bind të kundërtën të cilës duhet t'i përgjigjemi me "pse atëherë ne do të duhej të besonim çdo gjëje që ata thonë?". Kosova ka mundësi t'ju bashkangjitet liderëve në lëvizjen ndërkombëtare kundër duhanit. Për të mirën e njerëzve dhe të ardhmen e saj Kosova duhet ta shfrytëzoj këtë mundësi.

Martin Mc Kee, është Profesor i Shëndetësisë Publike Europiane në Shkollën e Higjienës dhe Mjekësisë Tropikale në Londër.

Fatime Arënliu Qosaj, është Magjistër i Shëndetësisë Publike në Minisitri të Shëndetësisë, IPVQ të Kosovës.